



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.06.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magjistratëve (gjyqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 13:01.¹

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ridvan Hado*** (anëtar)

¹ Brenda orarit të zhvillimit të mbledhjes, ka pasur disa minuta pushim.

8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë pikë të rendit të ditës, anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala, eksperte (EWMI - INL).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjqqtar) për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magjistratëve (gjqqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e datës 5 qershor.

Siç jeni në dijeni, nga ana e Këshillit kërkohet sot vendimmarrja për katër çështje.

Në qoftë se nuk kemi diskutime mbi rendin e ditës, pa humbur kohë fillojmë me çështjen e parë e cila ka të bëjë me ngritjen e një Komisioni të Përkohshëm për

verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magjistratëve përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë.

Në fakt ky është një propozim që vjen nga Komisioni i Administrimit të Buxhetit. Siç jeni në dijeni, në zbatim të ligjit “Për statusin”, nenit 17 dhe VKM-së nr. 22, datë 15.01.2020 “Për miratimin e procedurës së detajuar, të kriterëve dhe të kushteve që magjistrati duhet të përmbushë për përfitimin e kredisë për qëllime banimi, interesat e së cilës financohen nga shteti”, është nënshkruar një Marrëveshje dypalëshe “Për kreditimin në kuadër të programit të subvencionimit të interesave të kredisë për magjistratin” midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Banka OTP Bank.

Në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së sipërcituar, më pas janë zhvilluar takime mes përfaqësuesve të Bankës OTP dhe përfaqësuesve të KLGJ-së, për të diskutuar mbi disa aspekte në lidhje me zbatimin e saj.

Në vijim, nga ana e përfaqësuesve të bankës u dërguan drafti marrëveshja kuadër ndërmjet Bankës OTP dhe ministrisë dhe kontrata e kredisë bankare, një kontratë tip e bankave të nivelit të dytë, që lidhet mes bankës dhe përfituesit (që në rastin konkret është magjistrati).

Të dy draft marrëveshjet pas konsultimeve me Drejtorinë së Shërbimeve Juridike, iu paraqitën Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, për shqyrtim dhe miratim dhe u autorizua si person përgjegjës për nënshkrimin e tyre Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pas komunikimeve me përfaqësuesit e bankës është bërë nënshkrimi përkatës.

Këshilli ka përmbushur gjithashtu edhe detyrimin ligjor për njoftimin e magjistratëve sipas disa shkresave datë 28.05.2021 drejtuar gjykatave të të gjitha niveleve.

Aktualisht, në bazën e të dhënave të krijuar dhe administruar nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve për Administratën, janë paraqitur kërkesat me shkrim, për shprehje interesi për trajtim me kredi për shtëpi, të financuar nga shteti, nga 7 (shtatë) magjistratë (gjyqtarë).

Këshilli më tej, në zbatim të Marrëveshjes dypalëshe lidhur midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe OTP Bank, një nga rolet që kryen është miratimi i listës së magjistratëve përfitues nga skema e subvencionimit.

Për këtë qëllim, ne si Komision kemi sugjeruar ngritjen e një komisioni të posaçëm për verifikimin e kushteve që duhet të plotësojë magjistrati për të përfituar kredi për banim dhe dokumentacionin së bashku me kërkesën e paraqitur pranë KLGJ-së, nga magjistratët (gjqqtarë) dhe miratimin e listës së magjistratëve përfitues nga skema e subvencionimit për t'ia përcjellë bankës.

Nga ana e Komisionit është vlerësuar që përbërja të jetë me tre anëtarë të KLGJ-së, dy anëtarë jogjqqtarë dhe një gjyqtar, si dhe në ushtrimin e veprimtarisë së tij, ky komision do të asistohet nga nëpunësit e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky është projekt-akti që ju kemi propozuar për sot. Nëse keni pyetje, jeni të hapur.

Bashkëlidhur ju kemi sjellë edhe Marrëveshjen që është miratuar ndërmjet Ministrisë dhe Bankës dhe më tej ndërmjet Bankës dhe KLGJ-së.

Po!

Irena Plaku: Në fakt është një diskutim në lidhje me anëtarët e Komisionit të cilët janë propozuar: dy anëtarë jogjqqtarë dhe një anëtar gjyqtar. Mendoj që duke pasur parasysh rregullat e komisioneve, neni 62 të ligjit, ku përgjithësisht është përcaktuar se anëtarët e komisioneve, sidomos kur ka të bëjë me të drejtat që përfitojnë nga statusi, përbëhen nga dy gjyqtarë dhe një jogjqqtar, përveç ato komisione që shprehimisht kjo dispozitë e ka parashikuar që të jetë i ndryshëm ky raport, mendoj që në këtë rast duhet të jetë dy gjyqtarë dhe një jogjqqtar, sepse ligji kur ka dashur për të përcaktuar që të jenë dy jogjqqtarë, e ka përcaktuar shprehimisht.

Kështu që unë propozoj ose mendimi im është që të jenë dy gjyqtarë dhe një jogjqqtar (duke qenë se lidhen me të drejtat që rrjedhin nga statusi për magjistratët).

Gjithashtu, duke qenë se ky do jetë një komision i përkohshëm, mendoj që vendimmarrës duhet të jetë Këshilli edhe në këto raste, siç bëjmë edhe në vendimmarrjet e tjera, për sa kohë që ligji nuk ka përcaktuar që komisioni i përkohshëm dhe ky i fundit të ketë të drejtën e vendimmarrjes. Domethënë lista e gjyqtarëve të kalojë... domethënë kriteret dhe të gjitha verifikimet të bëhen nga Komisioni përkatës, dhe lista më pas të miratohet nga Këshilli dhe të kalojë për procedurat më pas.

Naureda Llagami: Atëherë, nga ana e Komisionit, çfarë është vlerësuar?

Të gjithë procedurën e ka ndjekur Komisioni i Administrimit dhe Buxhetit dhe thamë, për të qenë më transparent dhe për të ngritur një komision brenda Këshillit dhe për të mos e angazhuar Këshillin në një veprimtari verifikuese të kriterëve që në fakt do ketë ky komision, menduam që të jetë një komision i posaçëm, i cili në bazë të ligjit trajton çështje të caktuara. Kur themi fjalën “trajton”, kjo nuk do të thotë që ai komision i posaçëm vetëm i trajton dhe nuk ka vendimmarrje, sepse ne kemi pasur kuptimin që me fjalën “trajtim”, përfshihet edhe vendimmarrja që do ketë për pjesën e listës së 7 vetëve që do jenë. Kjo ka qenë edhe duke marrë parasysh edhe natyrën që kanë komisionet e posaçme.

Mos harrojmë që kemi komision të posaçëm, shprehimisht siç thotë ligji, kur ju vlerësoni edhe ankimet që ka ndaj ILD-së, pra jo vetëm vlerësoni, por edhe vendosni mbi ato ankime. Pra tregon që këto lloj komisionesh të posaçme, që trajtojnë çështje të caktuara, e kanë këtë pjesën që mund t’i shmangim nga pjesa e vendimmarrjes.

Nga ana tjetër, edhe po të shkojmë tek pjesa e çështjeve që janë për mbledhje plenare, kjo mund të duket sikur është çështje që lidhet me statusin. Të gjithë çështjet në fakt duket sikur lidhen me statusin në mënyrë të tërthortë, por nuk është çështje shprehimisht e mbledhjes plenare, në ato çështje, në ato pika, në mënyrë prekluzive.

Lidhur me përmbajtjen e Komisionit, në fakt ne së bashku me Fatmirën e kemi menduar që do ishte mirë që të ishin dy anëtarë, për shembull ne kishim sugjeruar brenda komisionit tonë që të ishte një nga komisioni ynë (e para), sepse duke qenë një nga komisioni ynë, di komplet procedurën, sepse e kemi ndjekur. Lidhur me të qenit gjyqtar/jogjyqtar, në fakt ne si komision menduam që nuk përbënte ndonjë pengesë të

qenit gjyqtar/jogjyqtar, sepse kjo ishte pjesë e faktit që ky komision do të asistohet nga një staf administrativ i cili do të bëjë punën, dhe pjesa e të qenit një gjyqtar brenda, menduam që e ezauron merakun që mund të kishim tek pjesa e statusit.

Megjithatë prapë mbetet në vlerësimin tuaj. Nëse ju e gjykoni që përbërja duhet ndryshuar, – ok!

Ndërsa në pjesën e vendimmarrjes, ne si komision në fakt kemi rënë dakord... pra e kishim shqetësimin që ju parashtruat, por thamë që për sa kohë ky komision ngrihet në Këshill dhe Këshilli vetë e autorizon, e kapërcejmë pjesën e propozimit.

Fatmira Luli: Të japë edhe unë dy argumente në vazhdim të Nauredës?

Irena Plaku: Të flas unë njëherë. Vetëm për një gjë do kundërshtoj me pak fjalë. Për replikë. Atë që parashikon ligji për komisionet e përkohshme të cilat janë vendimmarrëse, për shembull tek komisioni ndaj vendimeve të ankimit të pushimit, e ka parashikuar shprehimisht që ky vendim i komisionit është i formës së prerë dhe nuk ka ankim, pra e ka përcaktuar vetë ligji që mos t'i lërë të drejtë ankimi, apo kur ka përcaktuar që komisioni vetë është vendimmarrës.

Në këtë rast, meqenëse nuk është i rregulluar, duke qenë se lidhet me të drejtat për statusin (Ok, lidhet në mënyrë më të drejtpërdrejtë, sepse normalisht të gjithë vendimmarrjet e Këshillit lidhen me statusin, por kjo është një nga të drejtat që i buron nga statusi), propozova që kjo vendimmarrje të jetë e tillë. Gjithsesi, normalisht është për vlerësim.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Po, Fatmira!

Fatmira Luli: Të them edhe unë dy fjalë.

Atëherë, ne në komision e diskutuam shumë gjatë se kush duhet të ishte përbërja e komisionit dhe nëse duhet të kishte vendimmarrje ajo dhe u nisëm nga fakti që Komisioni i Buxhetit dhe Administrimit përbëhet nga dy jogjyqtarë dhe një gjyqtar dhe ai vendos

për çështje të administrimit të buxhetit, që janë çështje të rëndësishme të gjithë sistemit gjyqësor. Dhe në varësi të kësaj, gjykuam që në analogji me këtë duhet të ishte edhe ky komision.

Për komisione të posaçme që kanë vendimmarrje, ne s'kemi vetëm rastin e Komisionit të ILD-së, kemi edhe rastin e komisionit që bën vlerësimin e gjyqtarëve për efekt të vetting-ut, dhe vendimet e tij nuk ia kemi nënshtruar mbledhjes plenare. Kështu që, për të qenë shumë më praktikë, për të mos ngarkuar Këshillin me të tilla vendimmarrje që në fund të fundit nuk bëjnë gjë tjetër veçse verifikojnë a ka kritere ligjore, s'ka kritere ligjore; nuk do bëjmë ndonjë gjë të madhe; nuk na është lënë të bëjmë vlerësim "i takon/s'i takon" jashtë kritereve, por vetëm të shohim a zbatohen, ndodhen në rastin kur... është totalisht formal si vendimmarrje. E gjykuam që do ishte në dobi të punës që të bëhesh në këtë mënyrë.

Alban Toro: Siç e tha edhe Fatmira, mos të bie në përsëritje, ka pasur raste ku komisione shumë të rëndësishme që kanë lidhje me statusin dhe karrierën e gjyqtarit, ia kemi besuar komisionit të veçantë, pa qenë nevoja të kalojë nëpërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe fjala është për komisionin që bashkëpunon me organet e vetting-ut. Kështu që në këtë aspekt nuk shikoj ndonjë risk. Përpos faktit që komponenti jogjyqtar këtu është në një farë mënyre të ekuilibrojë balancën brenda KLGJ-së; dhe po t'i shtoj edhe faktin që ata që kanë kërkuar kreditimin e gjyqtarëve, parashikimin në buxhet, kanë qenë jogjyqtarët. Fatkeqësisht ka pasur oponencë nga gjyqtarët për të mos u bërë. Që do të thotë, nuk ka ndonjë qasje negative të komponentit jogjyqtar në dëm të gjyqtarëve, dhe po t'i shtojmë edhe faktin tjetër që përpos kësaj analize që do bëjë ky komision i vogël, zakonisht bankat janë agjentë të fondit që jep juria, dhe si agjentë ata kujdesen që risku të jetë minimalist për të mos ia kthyer kredinë. Ajo kredi do kthehet, me atë interes që ata kanë vendosur, dhe këtu nuk është se po bëjmë në fund të fundit ndonjë kontribut të jashtëzakonshëm ndaj gjyqtarëve, sepse ai ato para do t'i kthejë, do vijë dita dhe monedhën/qindarkën më të fundit do t'ia kthejë qeverisë. Kjo është thjesht një ndihmë fillestare që qeveria po i jep duke i vënë në dispozicion një fond për një strehim komod (se jam i sigurt që ajo vlerë nuk do dali me vlerën aktuale të tregut që ka kreditimi këtu,

dhe do t'i duhet gjyqtarit të shtojë akoma fonde për të pasur një ambient më të përshtatshëm). Po ta shikosh të gjithë procedurën (U mbars mali dhe polli një mi, – thotë populli në fund të ditës), që do të thotë që këto pak metra katrorë që qeveria po të ndihmon t'i do t'i kthesh një ditë se s'bën. Dhe në fund të ditës, çfarë ka bërë ky komision i vogël? Ka pasur në dispozicion ca letra, i ka analizuar, ka marrë një vendimmarrje, të cilat më pas do të analizohen prapë nga banka (se është agjent). Në fund të ditës banka do të duhet të jetë e sigurt që këto para do t'i kthehen buxhetit të shtetit, do të rimbursohen, siç janë marrë. Kështu që, duke pasur parasysh praktikën e konsoliduar të KLGJ-së që i ka deleguar kompetenca të caktuara komisioneve të caktuara që janë shumë më të rëndësishëm se kjo, prandaj po bëj diferencën midis rëndësisë, njëra ka lidhje me karrierën, kjo ka lidhje me ca fonde që gjyqtari në fund të ditës do t'i kthejë, t'i rimbursojë atë që i ka marrë buxhetit të shtetit, se nuk po ia fal njeri. Më duket edhe është kompetencë e komisionit të strategjisë që kompozimin e ka të tillë. Pra nga pikëpamja formale, por edhe e thelbit nuk shoh ndonjë problematikë që të jetë ky kompozim.

Irena Plaku: Për sa i përket përbërjes së komisionit, nuk diskutoj anëtarët pjesëmarrës, është gjyqtar apo jogjyqtar, sepse ligji kur i ka parashikuar disa kritere që të jenë edhe jogjyqtarë për balancim. Por kur e lidh me statusin, ligji vetë, tek komisionet, për shembull tek Komisioni i Disiplinës, tek Komisioni i Vlerësimit, për të garantuar këtë gjë, ka dhënë përparësi që të jenë dy gjyqtarë. Nuk ka lidhje se kush është pro dhe kush është... anëtari le të zgjidhet me short, nuk ka asnjë problem për mua personalisht sepse përderisa jemi të gjithë anëtarë, kemi të drejtën e votës të gjithë. Këtë mendoj. Nuk ka lidhje me faktin se kush është pro më shumë gjyqtarëve dhe kush është jo kundër gjyqtarëve. Atëherë, po flasim për atë që garanton ligji. Ligji vetë kur e ka përcaktuar që duhet të jetë anëtar jogjyqtar, domethënë raportin, e ka përcaktuar them unë. Dhe po ta shikosh dispozitën, kur thotë për gjyqtarët, të drejtat që lidhen me statusin, të përfituara nga statusi, i vendos dy anëtarë gjyqtarë. Tani, qëllimin e ligjit nuk e diskutoj. Kështu që për sa i përket përfitimit të kredisë, listën e përcaktojmë neve njëherë në radhë të parë, ose Komisioni ose Këshilli, vendosi emrin si të duash domethënë. Më pas procedurat do t'i bëjë banka. Nga shteti do të paguhet interesat, patjetër.

Alban Toro: E ka banka fjalën e fundit.

Irena Plaku: S'besoj që banka nuk do miratojë listën që do bëjmë neve.

Alban Toro: Ajo merr listën, e shikon me vëmendje dhe në fund i thotë gjyqtarit që ju i dashur gjyqtar nuk plotësoni problemin e kolateralit, nuk ke mundësi për ta kthyer (një nga aspektet). Sepse gjyqtari normalisht nuk do marri 50m2.

Irena Plaku: Pa kolateral njëherë, ligji të përjashton fare.

Alban Toro: Kë përjashton?

Irena Plaku: Të përjashton nga marrja e kredisë.

Alban Toro: Kë përjashton?

(Zoti Toro dhe zonja Plaku flasin mbi njëri-tjetrin)

Irena Plaku: Po s'ka kolateral nuk merr kredi.

Alban Toro: E ka me akte normative atë banka.

Irena Plaku: Po flas për dispozitën neni 17. *(e ripërsërit)*

Alban Toro: Neni 17 trajton fondin që i jepet në dispozicion gjyqtarit. Nga ana tjetër banka ka aktet e veta normative që normatohen nga Banka e Shqipërisë dhe nuk jep rrisqe të zbuluara, pra kreditime pa kolateral, por të detyron ty, meqenëse KLGJ-ja të paska individualizuar si person që duhet të përfitosh nga ky fond, të më bllokosh në emër të bankës shtëpinë, banesën që ti do blesh. E ka të detyrueshme këtë. Pra nuk qenke ti

intelektori/përcaktuesi i vetëm i listës emërore, por është edhe një agjent tjetër që na veproka në prapavijë dhe që administron këtë fond.

Me çfarë shikoj unë? E para, unë konstatoj që ti s'pasje probleme me pjesën e komponentit "jogjyqtar", domethënë je dakord; me jogjyqtarët qasja është pozitive. Problemin e shikon tek ngjyrimi që i jep, sepse ligji në mënyrë uniforme, në shumë raste, kompozimin e shikon dy gjyqtarë me një jogjyqtar. Ndërkohë, në rastin konkret po të sjell shembuj ku objekt i trajtuar është nga Komisioni i Strategjisë i cili ka një kompozim tjetër. Në lidhje me delegimin që vetë Këshilli e ka kaluar Komisionin e Vetting-ut (se po më thua problemin e statusit), ke pasur rastin e Komisionit të veçantë të Vetting-ut; ka lidhje me karrierën; ka kaluar nga Këshilli; e ka komisioni i veçantë. Apo s'ka lidhje me karrierën ajo? Se po më thua është karriera primare dhe meqenëse qenka karriera, duhet të jenë dy gjyqtarë. Ai komision i veçantë që ka lidhje me karrierën e gjyqtarit dhe që është shumë i rëndësishëm nga pikëpamja e dokumentacionit sepse bën një analizë profesionale të gjyqtarit dhe ia kalon organit të vetting-ut, na qenka i përjashtuar nga KLGJ-ja. Pra merr një vendimarrje në emër të KLGJ-së dhe për KLGJ-në.

Naureda Llagami: Atëherë, ky është një vlerësim që ka bërë Komisioni ynë. E hedhim në votim. Nëse ju e gjykoni ndryshe, se në fund të fundit për ju gjyqtarët është, nëse ju gjyqtarët vendosni që duhet të jenë më shumë gjyqtarë, e ndryshojmë.

Ne menduam tek Komisioni ynë që duhet të ishte me këtë. Pjesa tjetër pastaj, në momentin që ne delegojmë kompetencën, jemi në mbledhje plenare, ia dërgojmë një komisioni, atëherë ia japim atë besim komisionit për ta vijuar procesin.

Jo, s'po flasim për emra këtu, se emrat do të hidhen me short.

Flasim me pozicion.

Unë e kuptoj shqetësimin tuaj. E nisim me propozimin, hedhim në...

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Atëherë, unë diskutimin do ta nis së fundi nga standardi që ka mbajtur Këshilli. Projekt-akti që sot na vjen ne për diskutim dhe miratim në plenare ka dy çështje thelbësore që trajton: i) çështjen se kush do verifikojë dokumentacionin dhe plotësimin

e kriterëve dhe ii) çështjen se kujt i takon autoriteti i miratimit të listës përfundimtare që i çohet bankës.

Banka sigurisht që ka politikat e saj dhe ka edhe ajo rregullat e brendshme që janë përcaktuar edhe në memorandum, mbi bazën e të cilave mund edhe të refuzojë dhënien e një kredie për një gjyqtar. Por banka nuk dublon kompetencat e Këshillit. Pra banka mund të thotë ti je debitor i keq dhe nuk të takon kredi, por banka nuk mund të thotë që ti nuk ke tre vjet, siç është kushti. Pra të tjera kushte verifikon Këshilli, të tjera kushte verifikon banka, – e para.

E dyta, sjell në vëmendjen tuaj që ne miratojmë në mbledhje plenare listat për KED. Listat për KED janë thjesht verifikim për përvojën profesionale dhe nëse gjyqtari ka masa disiplinore apo jo. Miratojmë listën e Kolegjit Zgjedhor. Pra ne vetë si Këshill e kemi vendosur këtë praktikë që, sa herë që bëhet fjalë për miratim listash, ne mblidhemi të gjithë në plenare dhe madje ka pasur diskutime këtu që, ne këtu jemi, pse të mos i miratojmë të gjithë bashkë. Unë kam qenë ndoshta mund të them nga disa anëtarë të Këshillit që i mëshojmë me të madhe dhënies së autoritetit vendimmarrës të komisionit, por çdo komision i përhershëm vendimmarrjen e vet e ka brenda fushës së veprimtarisë së vet. Akoma nuk e kemi miratuar atë rregulloren e brendshme që i ndan këto fushat e çdo veprimtarie të komisionit. Në këto kushte nuk mund të themi sot, të ndryshojmë kushtet dhe të themi që këtij komisioni të përkohshëm do t'i japim attribute vendimmarrëse. Po, ky komision i përkohshëm, për sa kohë që Komisioni i Planifikimit Strategjik ka vlerësuar që kjo është një çështje e veçantë që kërkon një komision tjetër, pra nuk është një çështje brenda fushës së veprimtarisë së Komisionit të Planifikimit Strategjik, sepse komisioni mund ta mbante këtë çështje brenda fushës së vet, bënte verifikimet dhe i sillte në plenare thjesht për miratimin e listës. Jam dakord, është një çështje që është çështje e veçantë, sepse ka disa verifikime dhe në kuadër të verifikimeve, referuar VKM-së, përveç faktit që ky komision do të verifikojë përvojën profesionale; e dyta, nëse gjyqtari ka përfituar më parë kredi apo jo; nëse ka përfituar ndonjë kredi të subvencionuar nga shteti ndonjë person tjetër brenda familjes së gjyqtarit (lexoj nenin 6 të VKM-së nr. 22); duhet të verifikojë nëse magjistrati ose bashkëshorti/fëmija kanë në pronësi pasuri të paluajtshme pa kolateral për qëllime banimi ose pasuri të paluajtshme

që përdor veprimtari tregtare; do të verifikojë nëse kanë apo jo pasuri të mjaftueshme, likuiditete në vlerën e kredisë që duhet të përfitonte për të blerë një pasuri (dhe jep edhe përkufizimin e pasurisë së mjaftueshme). Përveç këtyre kritereve ai duhet të verifikojë edhe një dokumentacion. Pjesë e rëndësishme e këtij dokumentacioni sipas VKM-së janë edhe deklaratat e interesave private të gjyqtarit.

Nisur nga kjo punë veprimtare e komisionit, unë jam dakord që Komisioni të verifikojë plotësimin e kushteve, të verifikojë edhe dokumentacionin, por propozimin nëse këta janë gjyqtarët që përfshihen në listë apo këta janë gjyqtarët që nuk përfshihen në listë (mund të ketë edhe gjyqtarë që nuk i plotësojnë kushtet nga ata që aplikojnë), duhet ta sjellë për miratim në plenare dhe ne të gjithë bashkë, sikundër kemi bërë edhe për miratim listash të tjera, ta miratojmë. Nuk është një çështje që do të zvarritet apo do të sjellë burokracira të tjera.

Kjo për sa i përket vendimmarrjes. Vlerësoj që vendimmarrjen, pra miratimin e listës përfundimtare duhet ta ketë Këshilli.

Tani lidhur me komisionin, i vetmi rast që nuk e kemi kaluar në Këshill ka qenë raportet ndihmëse që bëhen për organet e rivlerësimit dhe unë kam propozuar vetë në atë kohë që komisioni i cili bën raportet ndihmëse të vlerësimit të aftësive profesionale për gjyqtarët, të mos kalonte nga Këshilli sepse i binte që Këshilli të merrte dy vendime. Duke qenë se ne bëjmë gradime, ne nuk mund të merrnim një vendim paraprak për miratimin e raportit të vlerësimit të gjyqtarit. Ai në fund të fundit është raport, nuk është vendim. Ai është raport ndihmës. Vendimin e kanë organet e rivlerësimit. Ato thonë që ti kalon apo jo nivelim minimal, vjen në Këshill pastaj për të përcaktuar gradën. Pra nuk është vendimmarrës në thelb në nxjerrjen e një akti administrativ komisioni i vlerësimit për efekt të vetting-ut.

Nga ana tjetër, ligji në ato raste kur komisionin e përkohshëm e ka bërë vendimmarrës, e ka bërë në mënyrë të shprehur. Thotë: “Vetëm komisioni që verifikon ankimet është komision vendimet e të cilit kanë formë të prerë”. Komisionet e përkohshme trajtojnë çështje të veçanta dhe vendimmarrëse bën vetëm komisionet e përhershme të Këshillit.

Për këtë arsye, mendoj që miratimi i listës duhet patjetër të kalojë me vendim të mbledhjes plenare. Një pikë do të jetë në rendin e ditës. Dokumentacioni do të na vijë i detajuar nga komisioni i përkohshëm dhe do të miratojmë listën e cila pastaj do t'i përcillet bankës.

Lidhur me përbërjen e komisionit. Komisionet e përkohshme gjithmonë i kemi krijuar: dy gjyqtarë dhe një jogjyqtar. Flas këtu komisionin e verifikimit të kriterëve për kandidatët që aplikojnë për ndihmës ligjorë, këshilltarë ligjorë, apo opinionin për Shkollën e Magjistraturës, dhe komisione të tjera. Lista janë edhe ato në fund të fundit. Nuk futesh në kriterë pasurie, por shikon vetëm a ke masë disiplinore, përvojë profesionale, dhe kaq. Ato vijnë dhe miratohen në plenare. Kështu që, unë për këtë qëllim mendoj që çështja duhet të vijë në plenare me përbërje komisioni: dy anëtarë gjyqtarë dhe një anëtar jogjyqtar, sepse nuk është çështje e besueshmërisë tek ato çfarë përfaqëson secili anëtar, por është çështje ligji, që për sa kohë ligji thotë që komisionet krijohen nga dy anëtarë gjyqtarë dhe një anëtar jogjyqtar, mendoj që nuk ka ndonjë pengesë.

Naureda Llagami: Po, zoti Toro!

Alban Toro: Atëherë, është e njëjta materie që na trajton me dy standarde të ndryshme, kur vjen pjesa e punës së komisionit të vetting-ut ai është komision që ligji s'ë ka parashikuar ne kemi parashikuar dhe i kemi deleguar kompetenca të plota që ai të veprojë si entitet dhe përfaqësues i vetëm dhe të flasë në emër të KLGJ-së, që s'ka lidhje fare me pjesën që ne bëjmë gradimin, çfarë bëhet me raportin, se i bie që ai komision që paska miratuar raport, na paska bërë shkelje tani që paska qenë prezent kur kemi marrë vendimmarrje për gradimin, që s'ka lidhje dhe kjo pjesë, nga pikëpamja qoftë e materies, qoftë e procedurës. Gjithsesi është konstatuar që për këtë komision është kërkuar nga elementë të cilët kanë ardhur nga jogjyqësori, pra për t'u parashikuar ky fond i famshëm për kreditimin e gjyqtarëve dhe iniciatorë janë bërë po këta elementë që vijnë nga jogjyqësori, dhe duke qenë që është produkt që vjen nga Komisioni i Strategjisë është bërë mirë që është parashikuar që ngjyrimi i këtij komisioni të ketë vetëm dy jogjyqtarë dhe një gjyqtar (të vijnë nga ky burim).

Pastaj, në lidhje me listën, nëse do të miratohet apo jo lista, kushdo që përjashtohet, po themi, pa të drejtë, ka procesin e ankimit të cilin e ka të hapur dhe nuk ia heq askund dhe askush, sepse ia njeh ligji.

E fundit që dua të përsëris dhe që është sensibil është që pavarësisht se miratohet një listë, banka ka një proces të vetën vlerësimi për kreditim për anëtarët e listës. Pra ka parashikuar dy filtra Këshilli i Ministrave, një filtër na qenka KLGJ-ja, por i fundit e ka agjenti i cili vepron në emër të qeverisë për kreditim, dhe është banka. Banka në fund bën një analizë risku, bë një analizë për kredinë që do të marri, bën një analizë mbi bazë dokumentacioni që i serviret, dhe mund të kërkojë dhe nuk ia përjashton dot njeri të kërkojë edhe një kolateral sepse duhet të jetë e sigurt që ai fond do të rimburohet. Kështu që në këtë aspekt nuk shikoj asnjë lloj problematike për ta zgjatur kaq shumë për një gjë që është sqaruar nga Komisioni.

Naureda Llagami: Atëherë, në fakt edhe një herë për ta përfunduar qëndrimin e Komisionit. Neve në fakt e kemi menduar që është Këshilli që delegon tek ky Komision dhe për të qenë edhe më transparent komisionin e kemi propozuar që të jetë me gogla. Në fakt, propozimi ynë ka qenë që një nga Komisioni ynë duhet të jetë atje për faktin që një anëtar i komisionit tonë ka ndjekur të gjithë procedurën, nga dita një, që kur erdhi propozimi në mbledhjen plenare për t'u përfshirë ky fond në buxhetin e shtetit dhe deri në ditën e sotme që e kemi të mundur zbatimin e saj, kështu që ne do propozonim që në këto dy anëtarët jashtë gjyqësorit, një të ishte nga Komisioni i Buxhetit, duke qenë se njeh të gjithë procesin e miratimit të marrëveshjeve. Megjithatë kjo mbetet në vlerësimin e Këshillit. Kështu që për procedurë fillojmë me propozimin e sjellë...

Dritan Hallunaj: Më fal, nëse mundem Kryetare?

Naureda Llagami: Po!

Dritan Hallunaj: Atëherë, së pari, për sa i përket përbërjes së Komisionit, unë po shpreh qëndrimin tim që Komisioni duhet të ketë në përbërje dy gjyqtarë dhe një

jogjyqtar. Së dyti, për sa i përket pjesës që u pretendua apo kërkohet që kjo listë e miratuar nga Këshilli, – jam kundër kësaj për shumë arsye, pasi siç u tha edhe nga parafolësit është banka ajo që do ta ndjekë dhe besoj që edhe Komisioni mund ta realizojë lehtësisht një procedurë të tillë që ka të bëjë thjesht dhe vetëm me disa kritere formale. Pra cekohen, a ekziston kjo apo nuk ekziston? I takon apo s'i takon? Nëse janë, kalon. Nëse nuk e ka njërin nga ato kritere, nuk kalon. Për sa i përket Komisionit që u diskutua, Komisioni i raporteve profesionale, në ndihmë të KPK-së, ju rikujtoj se Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë, pra nuk është tre anëtarë, ka pesë anëtarë. Dhe një marrëveshje që është bërë më përpara me KPK-në, nëpërmjet ish-KLD-së, me KLGJ-në, e përditësuar marrëveshja, ka qenë e tillë që produkti të mos kalojë në mbledhje plenare, dhe për shpejtësi dhe për operativitet të veprimeve, si dhe për faktin tjetër që aty thjesht jemi organ ndihmës. Po ta banalizojmë edhe në këtë rast do të jemi një organ ndihmës për sa i përket bankave.

Në këto kushte unë jam që të ketë një komision; të jetë Komisioni vendimmarrës i miratimit të listës, përbërja e tij të jetë dy që vijnë nga radhët e gjyqtarëve dhe një nga radhët e jogjyqtarëve.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Hallunaj!

Atëherë i hedhin në votim duke qenë se ju u bashkuat në një pikë me zonjën Irena Plaku, kështu që fillimisht hedhim në votim pjesën e përbërjes së Komisionit, nëse Komisioni do të jetë me dy gjyqtarë dhe një jogjyqtar. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Kundër.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Atëherë kalon propozimi që do jenë dy gjyqtarë dhe një anëtar jogjyqtar.

Unë isha kundër.

Jemi 5 me 5?

(Zonja Llagami është pro propozimit të Komisionit.)

Rrëzohet propozimi. Vazhdon të jetë sipas propozimit të Komisionit.

Naureda Llagami: Argumenti i dytë që Komisioni të jetë propozues për mbledhjen, por jo vendimmarrës.

Ilir Rusi: Kundër.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Dritan Hallunaj: Edhe një herë, ndjesë se edhe unë u keqkuptova, meqenëse nuk jam (jam online). Unë jam kundër që të shkojë në mbledhje plenare.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Kundër.

Naureda Llagami: Kundër.

(Nuk miratohet.)

Naureda Llagami: Atëherë, hedhim në votim propozimin e Komisionit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord, për sa kohë u miratua nga shumica.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Naureda Llagami: Atëherë, lidhur me përbërjen. Në fakt ne si Komision do të donim, unë në cilësinë e Kryetares do të doja që një nga anëtarët e Komisionit të ishte zonja Fatmira Luli si person kyç, i cili ka ndjekur të gjithë procesin e marrëveshjes dhe për dy anëtarët e tjerë të bëhet përzgjedhja me short. Nëse pranohet nga ju.

Atëherë, edhe një herë. Jemi dakord me propozimin tim, zonja Luli të jetë anëtare e Komisionit?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Kryetare, meqenëse po hidhet short edhe për dy anëtarët, më mirë të bëjmë dy shorte, një për tre nga ju dhe për pjesën tjetër pastaj për dy të tjerët.

Naureda Llagami: Po menduam që ta kishim zonjën Luli si pjesë të gjithë praktikës, vijueshmërinë që ka pasur me të gjithë praktikën. Ky është propozim i Komisionit Dritan. Pra është marrë me praktikën dhe të jetë pjesë e asaj, për të ndihmuar edhe kolegët. Duke qenë që është një praktikë që po bëhet për herë të parë.

Dritan Hallunaj: Nuk kam kundërshtim unë për emrin.

Thashë, meqë do bëhet një short, pse mos ta bëjmë për dy anëtarët një short dhe për anëtarin tjetër një short tjetër. Për mua nuk ka rëndësi.

Naureda Llagami: Dy shorte do bëjmë. Një për jogjyqtar dhe një për gjyqtar.

Dritan Hallunaj: Po them kot, se s'ka rëndësi për mua.

Thjesht për procedurë.

Naureda Llagami: Unë po them çfarë kemi vendosur në Komision në fakt. Në qoftë se ju vlerësoni kundër, s'e kam problem. Vazhdoni!

Dritan Hallunaj: Si të doni për mua.

(Vazhdon votimi aty ku u la)

Ridvan Hado: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord jam unë.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

(Miratohet. Zonja Luli do të jetë një nga anëtarët jogjyqtarë të këtij Komisioni dhe nuk do jetë pjesë e shortit.)

Naureda Llagami: Atëherë ftoj administratën që të hedhim shortet për, një nga radhët e jogjyqtarëve dhe një nga radhët e gjyqtarëve. Gjithashtu edhe për zëvendësuesit e tyre.

Procedura e shortit si vijon:

Në enën e parë të qelqit futen në rend alfabetik shiritat e letrës me emrat e anëtarëve gjyqtarë: znj. Brikena Ukperaj, z. Dritan Hallunaj, znj. Irena Plaku, z. Klodian Kurushi, znj. Marçela Shehu, z. Ridvan Hado.

Në enën e dytë të qelqit futen në rend alfabetik shiritat e letrës me emrat e anëtarëve jogjyqtarë, ku sipas asaj që u miratua më herët nga Këshilli, zonja Luli nuk

merr pjesë në short pasi është tashmë pjesë e Komisionit: z. Alban Toro, z. Ilir Rusi, znj. Yllka Rupa.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Përzgjidhet emri i anëtarit gjyqtar që do të jetë pjesë e Komisionit. Përzgjidhet z. Dritan Hallunaj. Zgjidhet emri i anëtarit gjyqtar zëvendësues. Përzgjidhet znj. Irena Plaku.

Përzgjidhet emri i anëtarit jogjyqtar që do të jetë pjesë e Komisionit. Përzgjidhet z. Alban Toro. Përzgjidhet emri i anëtarit jogjyqtar zëvendësues. Përzgjidhet z. Ilir Rusi.

Naureda Llagami: Atëherë, hedhim në votim në tërësi tashmë aktin, me gjithë emrat.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1.Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magjistratëve (gjyqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë, i përbërë nga dy anëtarë jogjyqtarë dhe një anëtar gjyqtar, si më poshtë:

1. Znj. Fatmira Luli, anëtare e KLGJ-së.
2. Z. Alban Toro, anëtar i KLGJ-së.

3. Z. Dritan Hallunaj, anëtar i KLGJ-së.

Gjithashtu ka zgjedhur edhe dy anëtarët zëvendësues:

Nga radhët e gjyqtarëve znj. Irena Plaku.

Nga radhët e jogjyqtarëve z. Ilir Rusi.

2. Komisioni ka për detyrë, verifikimin e kushteve që duhet të plotësojë magjistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim, dhe dokumentacionin së bashku me kërkesën, e paraqitur pranë KLGJ-së, nga magjistratët (gjyqtarë) dhe miratimin e listës së magjistratëve (gjyqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë.

3. Komisioni, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij mbështetet nga nëpunësit e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

4. Në përfundim të procesit të verifikimit, Komisioni nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, dërgon pranë bankës, listën e magjistratëve (gjyqtarë) përfitues.

5. Komisioni, do ta ushtrojë veprimtarinë e tij, për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij vendimi deri në datë 31.12.2023.

6. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.06.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të gjykatave administrative të shkallës së parë Durrës, Korçë dhe Shkodër, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 13:01.²

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Illir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

² Brenda orarit të zhvillimit të mbledhjes, ka pasur disa minuta pushim.

9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala, eksperte (EWMI - INL).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të gjykatave administrative të shkallës së parë Durrës, Korçë dhe Shkodër, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Marçela Shehu).

(Përpara fillimit të çështjes nr. 2, bëhen disa minuta pushim nga anëtarët e Këshillit.)

Naureda Llagami: Vazhdojmë mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, fjalën ia jap zonjës Shehu e cila do të relatojë “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër”. Fjalën zonja Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit!

Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit i paraqet mbledhjes plenare për shqyrtim projektvendimin “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër”.

Akti i propozuar për miratim ka për qëllim krijimin e Komisionit të Ristrukturimit për vijimin e funksionimit dhe veprimtarisë së gjykatës sipas parashikimeve ligjore që autorizojnë KLGJ-në për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit, duke zbatuar për aq sa është e mundur edhe rregullimet konkrete të ligjit “Për Shërbimin Civil”, si dhe praktikatat më të mira në këtë drejtim.

Komisioni i Ristrukturimit është një strukturë e përkohshme, përbërja e të cilit mundëson të sigurojë një proces legjitim dhe të balancuar, ku objektivi kryesor mbetet krijimi i një administrate me aftësitë e nevojshme profesionale dhe integritet të lartë.

Në zbatim të vendimit nr. 557, datë 29.12.2022 të KLGJ-së “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisioneve të Ristrukturimit”, nenit 66 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili, midis të tjerash, parashikon se në rast të mbylljes ose riorganizimit të strukturës së gjykatës, Këshilli i Lartë Gjyqësor ngrë Komisionin e Ristrukturimit, sipas ligjit “Për nëpunësin civil”. Komisioni i Ristrukturimit drejtohet nga një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe kryetarët dhe kancelarët e gjykatave që i nënshtrohen procedurës së riorganizimit, si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, Komisioni i Ristrukturimit i cili do të shqyrtojë mundësinë e sistemimit të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë, të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër, do të përbëhet nga kryetarët dhe kancelarët e gjykatave që i nënshtrohen riorganizimit të kompetencave tokësore, gjykatës pritëse si dhe do të drejtohet nga një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në mungesë të kryetarit ose të kancelarit, anëtarë të komisionit janë zëvendëskryetarët dhe nëpunësit që ushtrojnë detyrat e kancelarit, më konkretisht nga të gjitha gjykatat, do të jenë anëtarë të Komisionit të Ristrukturimit Zëvendëskryetarët e gjykatave dhe për Gjykatën Administrative Shkallës së Parë Shkodër do të jetë anëtar nëpunësi i caktuar për kryerjen e detyrave të kancelarit të gjykatës.

Referuar dispozitave ligjore në fuqi për shërbimin civil publik, për aq sa na mundësohet zbatimi i tyre, sipas parashikimeve në nenin 9 të ligjit 98/2016 “Për pushtetin gjyqësor”, i ndryshuar, Komisioni i Ristrukturimit drejtohet nga përfaqësues i njësisë përgjegjëse, ku në institucione të pavarura këto funksione ushtrohen nga struktura përgjegjëse për burimet njerëzore, apo nga nëpunësi më i lartë i institucionit në varësi të së cilës janë institucionet që i nënshtrohen procesit të riorganizimit.

Komisioni i Ristrukturimit i cili do të funksionojë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, do të shqyrtojë mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil gjyqësor dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër, që i nënshtrohen riorganizimit, në strukturën dhe organikën e gjykatave pritëse, por duke pasur parasysh edhe pozicionet vakante në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Korçë dhe Shkodër.

Pra në rast pamundësie në gjykatën pritëse, do shikohet pozicionimi në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm.

Procesi i riorganizimit të gjykatave kërkon para së gjithash që të ruhet kapaciteti profesional aktual i gjykatave, si e vetmja mënyrë për të siguruar ofrimin e shërbimeve cilësore.

Akti i propozuar do të zbatohet nga anëtarët e Komisionit të Ristrukturimit, Kryetarë / Zv.Kryetarë dhe Kancelarë të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Durrës, Korçë dhe Shkodër, si dhe KLGJ.

Në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi, konkretisht në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Projekt-akti është i plotësuar edhe me emrat e të gjithë Komisionit, përveç përfaqësuesit të Këshillit, duke qenë që do të përcaktohej sot në mbledhjen plenare.

Naureda Llagami: Në kushtet që ne propozojmë z. Ilir Rusi, atëherë po hedhim në tërësi të gjithë aktin me gjithë emrat.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër, me përbërje:

– Z. Ilir Rusi – Kryetar (përfaqësues i KLGJ-së);

– Z. {...} – Anëtar (Zv.Kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës);

– Znj. {...} – Anëtar (Zv.Kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë);

– Znj. {...} – Anëtar (Zv.Kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër);

– Znj. {...} – Anëtar (Zv.Kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë);

– Znj. {...} – Anëtar (Kancelar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës);

– Z. {...} – Anëtar (Kancelar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë);

– Znj. {...} – Anëtar (Nëpunës që ushtron detyrat e Kancelarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër);

– Znj. {...} – Anëtar (Kancelar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë).

2. Komisioni i Ristrukturimit i Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër, i cili ushtron funksionet pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, do të shqyrtojë mundësinë e sistemimit të nëpunësve civilë

gjqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër, që i nënshtrohet riorganizimit, në strukturën dhe organikën e gjykatës pritëse (Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë).

3. Komisioni i Ristrukturimit, do të shqyrtojë edhe mundësinë e sistemimit të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër, në strukturat e Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Korçë dhe Shkodër.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.06.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe Vlorë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 13:01.³

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** *(kryetare)*
- 2. Ilir Rusi*** *(zëvendëskryetar)*
- 3. Klodian Kurushi*** *(anëtar)*
- 4. Fatmira Luli*** *(anëtare)*
- 5. Irena Plaku*** *(anëtare)*
- 6. Dritan Hallunaj*** *(anëtar)*
- 7. Ridvan Hado*** *(anëtar)*
- 8. Alban Toro*** *(anëtar)*
- 9. Marçela Shehu*** *(anëtare)*

³ Brenda orarit të zhvillimit të mbledhjes, ka pasur disa minuta pushim.

10. Brikena Ukperaj (anëtare)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala, eksperte (EWMI - INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

7. BIRN.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër dhe Vlorë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Marçela Shehu).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër dhe Vlorë. Për më shumë detaje, prapë zonjës Shehu fjalën.

Marçela Shehu: Faleminderit!

Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit ka paraqitur njëkohësisht për shqyrtim dhe miratim projektvendimin “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër dhe Vlorë”.

Për të mos humbur shumë kohë, sepse është e njëjta analizë faktesh dhe ligji si për Komisionin e mëparshëm të Ristrukturimit, paraqitet për miratim projektvendimin i cili

është i plotësuar me të gjithë të dhënat e tij dhe me gjithë emrat e Komisionit, përveç përfaqësuesit të Këshillit i cili do të vlerësohet sot nga mbledhja plenare.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votim së bashku me propozimin e Këshillit që zonja Shehu të jetë Kryetare e Komisionit. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro. (përsëritet)

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe Vlorë, me përbërje:

– Znj. Marçela Shehu – Kryetar (përfaqësues i KLGJ-së);

– Z. {...} – Anëtar (Kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë);

– Z. {...} – Anëtar (Zv.Kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë);

– Znj. {...} – Anëtar (Kancelar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë);

– Znj. {...} – Anëtar (Kancelar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë);

2. Komisioni i Ristrukturimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe Vlorë, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, do të shqyrtojë mundësinë e

sistemimit të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër dhe Vlorë, që i nënshtrohet riorganizimit, në strukturën dhe organikën e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

3. Komisioni i Ristrukturimit, do të shqyrtojë edhe mundësinë e sistemimit të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër dhe Vlorë, në strukturat e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër dhe Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pra edhe një herë, meqë nuk është dëgjuar pika e dytë. Po e lexoj edhe një herë.

2. Komisioni i Ristrukturimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër dhe Vlorë, i cili ushtron funksionin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, do të shqyrtojë mundësinë e sistemimit të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër dhe Vlorë, që i nënshtrohet riorganizimit, në strukturën dhe organikën e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Naureda Llagami: Atëherë, me kaq i mbyllim çështjet që i kishim me dyer të hapura, për të vijuar Këshilli me çështjen e fundit, e cila për shkak të llojit të çështjes, zhvillohet me dyer të mbyllura.

Faleminderit!

Dritan Hallunaj: Unë bëj me dije që nuk mund të marrë pjesë për arsye shëndetësore. Kështu që nuk marrë pjesë dot tek kjo pikë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Dakord.

Gjithashtu edhe Yllka nuk është në këtë pikë.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor